

## **KOMISIONI PËR PËRCAKTIMIN E NXËNËSIT ME AFTËSI TË KUFIZUAR**

Në bazë të DPCM N. 185 datë 23 shkurt 2006

### **NJOFTIM PËR FAMILJEN**

Me këtë dokument, po ju dorëzohet, në tri kopje procesverbali i komisionit mbikëqyrës, për përcaktimin e nxënësit me aftësi të kufizuara.

Jeni të ftuar:

- 1) Të ruani në dokumentacionin tuaj një kopje të procesverbalit të dorëzuar në ditën e sotme;
- 2) Të dorëzoni së bashku me diagnozën funksionale, një kopje të procesverbalit në Institutin arsimor që frekuenton djali/vajza juaj, në mënyrë që vetë Instituti të përmbushë detyrimet e parashikuara për caktimin e mbështetjeve shkollore të nevojshme për favorizimin e integritet shkollor (mësuesi mbështetës në ngarkim të zyrës së shkollës dhe/ose asistenti edukator në ngarkim të komunës së rezidencës, pajisjet e shkollës paguhen nga Krahina). Në rast vërtetimi me kërkesë të "asistentit edukator", transmetimi i kopjes së Procesverbalit të Diagnozës funksionale komunës së rezidencës do të jetë nën kujdesin e drejtuesit të shkollës, duke përdorur skedën e transmetimit të nënshkruar nga familjari;
- 3) Të dorëzoni një kopje të procesverbalit tek Shërbimi i Specializuar (Njësia e Neuropsikiatrisë të fëmijëve, IRCCS, konsultori familjar...), që ka përgatitur certifikimin dhe diagnozën funksionale, bashkangjitur kërkesës për vërtetim.

Ju kërkohet, gjithashtu, të kontrolloni *skadimin e vlefshmërisë së vërtetimit* (që shënohet në fund të procesverbalit), në mënyrë që të bini dakord, brenda një kohe të duhur, për një verifikim me shërbimet e specializuara mbi gjendjen klinike të fëmijës e të vlerësoni së bashku nevojën e ventuale për të bërë kërkesën për ripërtëritjen e vërtetimit tek ASST Papa Giovanni XXIII.

Kujtojmë se është e mundur të paraqitet rekurs, kundër vendimit të komisionit, brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të procesverbalit pranë Drejtorisë Socio-shëndetësore të ATS nëpërmjet formularit specifik (MCoIac05), të pajisur me Certifikimin e ri diagnostikues e integritetimin e Diagnozës Funksionale, sipas mënyrave të mëposhtme:

- dorazi pranë Zyrës së Protokollit të ATS, via Gallicciolli n. 4 Bergamo (nga ora 8.30 deri 12.30 e nga ora 13.30 deri 16.00);
- me postë rekomandë R.R.;
- me e-mail, vetëm me anë të një poste elektronike të certifikuar (PEC), në adresën [protocollo@pec.ats-bg.it](mailto:protocollo@pec.ats-bg.it)

Me respekt.

Përgjegjësi  
Dr. Pietro Zoncheddu

Përgjegjësi i Procedimit: dr. Pietro Zoncheddu  
Funksionari Kompetent: Maddalena Badoni-Cinzia Valoti  
tel.0352676490 ; e mail: [disabilita.autismo@asst-pg23.it](mailto:disabilita.autismo@asst-pg23.it)